



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
-AUTORITETI I KONKURENCËS-  
KOMISIONI I KONKURENCËS**

Nr.           prot

Tiranë, më 14.10.2009

**V E N D I M**

**Nr. 125   Datë 08 .10. 2009**

**Për**

**“Vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve “Atlas” Sh.a dhe “Bloja” Sh.a për kufizim të konkurrencës në tregun e importit të grurit dhe prodhimit dhe shitjes së miellit për prodhimin e bukës”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e :

- Znj. Lindita Milo (Lati)   Kryetar
- Znj. Servete Gruda       Anëtar
- Z. Koço Broka            Anëtar
- Znj. Rezana Konomi     Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 08.10. 2009, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Në lidhje me marrëveshjen e ndaluar ndërmjet ndërmarrjeve “Atlas “Sh.a dhe “Bloja” Sh.a për kufizim të konkurrencës në tregun e importit të grurit dhe prodhimit dhe shitjes të miellit për prodhimin e bukes

**Bazë ligjore:** Ligji nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 4 pika “1” , neni 24, shkronja “d”;  
Ligji Nr. 8485 datë 11. 11. 1999 “Kodi i Procedurave Administrative”,

Autoriteti i Konkurrencës në ushtrim të funksioneve të tij ligjore, iniciuar dhe nga shqetësimi i bërë prezent nga prodhuesit e bukës, si dhe shqetësimi mediatik lidhur me rritjen e çmimit të bukës në fillimet e vitit 2008, mori në konsideratë dhe vlerësoi nivelin e konkurrencës në tregjet e prekura.

Komisioni i Konkurrencës së Autoritetit të Konkurrencës, pas shqyrtimit të:

- Raportit të grupit të punës për hetimin e thelluar në tregun e importit të grurit dhe prodhimit të miellit, të hapur me Vendimin Nr. 88 datë 02.10.2008 të Komisionit të Konkurrencës;

- Relacionit të Sekretares së Përgjithshme
- Pretendimeve të “Atlas” Sh.a dhe “Bloja” Sh.a në seancën dëgjimore të datës 27.07.2009, si dhe ato me shkrim të dërguara pranë Autoritetit të Konkurrencës, përkatësisht me Nr. 287/1 datë 21. 07. 2009, 287/2 datë 21. 07.2009, 321 prot datë 13. 08. 2009, dhe 323 Prot datë 14. 08. 2009

## **V Ë R E N S E:**

### **I. PROCEDURA**

1. Procedura e ndjekur gjatë hetimit është bazuar në Kreun II dhe III të pjesës II të Ligjit Nr. 9121, datë 8.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (ketu e me poshte “Ligji” ) dhe Ligjit Nr. 8485, datë 11.11.1999 “Kodi i procedurave administrative”.
2. Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, germa “d” dhe nenit 43, pika 1 të ‘Ligjit’ si dhe nenit 21, pika 4, të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”, me Vendimet Nr. 88 datë 02.10.2008 Nr. 101 datë 05.02.2009 vendosi: “Hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit të grurit si dhe në tregun e prodhimit dhe shitjes së miellit për prodhimin e bukës”.
3. Në përfundim të procedurave hetimore, Sekretariati ka paraqitur raportin përkatës pranë Komisionit të Konkurrencës.
4. Komisioni i Konkurrencës nga shqyrtimi i këtij raporti, konstatoi ekzistencën e një marrëveshjeje të ndaluar në tregun e importit të grurit dhe prodhimit e shitjes së miellit midis ndërmarrjeve “Atlas” Sh.a dhe “ Bloja” Sh.a dhe me Vendimin Nr. 113 datë 19.05.2009, ka vendosur ndalimin e kësaj marrëveshjeje në zbatim të ‘Ligjit’.
5. Ky vendim si dhe raporti i hetimit të thelluar iu komunikua ndërmarrjeve “Atlas” Sh.a dhe “Bloja” Sh.a me anë të shkresës Nr. 228 datë 25.05.2009 të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës.
6. Në zbatim të nenit 39 të ‘Ligjit’ palët nën hetim paraqitën pretendimet e tyre mbi raportin e hetimit të thelluar në seancën dëgjimore si dhe me shkrim<sup>1</sup>, të cilat janë marrë në konsideratë nga Komisioni i Konkurrencës.

### **II. PERIUDHA E HETIMIT DHE NDËRMARRJET NËN HETIM**

7. Periudha e hetimit, e përcaktuar nga Komisioni i Konkurrencës në Vendimin Nr.88 datë 02.10.2008 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit të grurit dhe prodhimit të miellit”, është 01 Janar 2005 -31 Gusht 2008.
8. Ndërmarrjet nën hetim janë përcaktuar në Vendimet Nr. 88 datë 02. 10. 2008 dhe 101 datë 05. 02. 2009 të Komisionit të Konkurrencës.

---

<sup>1</sup> Përkatësisht shkresat 287/1 datë 21. 07. 2009, 287/2 datë 21. 07.2009, 321 prot datë 13. 08. 2009, dhe 323 prot datë 14. 08. 2009

### III. STRUKTURA E TREGUT

9. Tregu përkatës, në bazë të nenit 3 pikës 7 të 'Ligjit' dhe të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 76 datë 07. 04. 2008 "Për miratimin e udhëzimit për përcaktimin e tregut përkatës" përcaktohet në dy dimensione:

- a. Tregu i produkteve
- b. Tregu gjeografik

#### **III.1 Tregu përkatës i produktit**

10. Tregu përkatës i produktit përfshin:

- Tregun e importit të grurit për prodhimin e miellit<sup>2</sup>
- Tregun e prodhimit dhe të shitjes së miellit për bukë

Tregu gjeografik i referohet territorit të Republikës së Shqipërisë.

**Struktura e tregut të importit të grurit.** Tregu i importit të grurit paraqet karakteristikat e një tregu shumë të përqendruar<sup>3</sup>.

11. Pesë ndërmarrjet kryesore në tregun e importit të grurit janë "Bloja" Sh.a, "Atlas" Sh.a, "Shoqëria Anonime Miell" Sh.a, "IAM" Shpk dhe "Glan" Shpk. Pjesa e tregut<sup>4</sup> që zënë këto ndërmarrja (CR5) në vitet 2005-2008 është përkatësisht 95.66%, 95.37% 82.08% dhe 85.35%.<sup>5</sup>

#### **Nëntregu i shitjes së grurit për prodhimin e bukës.**

12. Gjate viteve 2005-2006 tregu i shitjes së grurit ka qenë shumë i përqendruar<sup>6</sup>. Nga analiza e pjesëve të tregut rezulton se për vitet 2005-2006, pesë konkurrentët kryesorë "Bloja" Sh.a, "Alagro" Shpk, "Shoqëria Anonime Mielli" Sh.a, "IAM" Shpk dhe "Vllaznimi B" Shpk, zotërojnë 100% të tregut

13. Në vitin 2007, konkurrentët kryesorë janë ndërmarrjet "Bloja" Sh.a, "IAM" Shpk, "Shoqëria Anonime Mielli" Sh.a, "ALAGRO" Shpk dhe "Vllaznimi B" Shpk që zënë 90% të tregut dhe në 8 mujorin e vitit 2008 CR5 është 78% ku ndërmarrjet e përfshira janë "Bloja" Sh.a, "Atlas" Sh.a, "Shoqëria Anonime Mielli" Sh.a, "IAM" Shpk dhe "GLAN" Shpk.

---

<sup>2</sup> Në analizën e tregut të importit të grurit, nuk është përfshirë sasia e importit të grurit për mbjellje dhe ajo e importit të grurit "durum", i cili përdoret për prodhimin e makaronave

<sup>3</sup> Indeksi i përqendrimit për vitin 2005 është 2191; për vitin 2006 është 2351, për vitin 2007 është 1545 dhe për 8 mujorin e vitit 2008 ky indeks është 1805

<sup>4</sup> Llogaritja e pjesëve të tregut është bërë nga përpunimi i të dhënave të siguruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

<sup>5</sup> CR5 për gjithë vitin 2008 është 82.7%, kurse HHI për vitin 2008 është 1725

<sup>6</sup> HHI (Indeksi i Herfindahl-Hirschmann) është matës specifik i përqendrimit të tregut. Ky indeks mbledh katrorët e pjesëve individuale të tregut të të gjithë konkurrentëve për të parë nivelin e përqendrimit të tregut. Në rastet kur HHI < 1000 tregu është jo i përqendruar, 1000 < HHI < 1800 - mesatarisht i përqendruar, HHI > 1800 - shumë i përqendruar. Indeksi HHI në vitin 2005 është 3142.7; në vitin 2006 HHI është 3331.4; në vitin 2007 HHI është 1841.9 dhe për 8-mujorin e vitit 2008 HHI është 1469.4

### **Tregu i prodhimit dhe shitjes së miellit për prodhimin e bukës.**

14. Nga analiza e pjesëve të tregut për vitet 2005-2006-2007 vihet re se pjesa e tregut e 3 ndërmarrjeve kryesore në treg (CR3), është relativisht shumë e lartë<sup>7</sup> ku tre ndërmarrjet “Atlas” Sh.a, “Bloja” Sh.a dhe “Miell Tirana” Sh.a janë ndërmarrjet kryesore në treg. Në vitin 2008 ndërmarrjet “Atlas” Sh.a dhe “Bloja” Sh.a zotërojnë pjesë të barabarta tregu me nga 25% secila.

15. Tre ndërmarrjet kryesore në tregun e shitjes së miellit (CR3) janë “Atlas” Sh.a, “Bloja” Sh.a dhe “Shoqëria Anonime Mielli” Sh.a të cilat zënë 88% për vitin 2005, 83% për vitin 2006, 73% për vitin 2007 dhe për periudhën janar-gusht 2008 zënë në 69% të tregut. Ndërmarrjet “Bloja” Sh.a dhe “Atlas” Sh.a ruajnë klasifikimin sipas pjesëve të tregut gjatë viteve 2006-2008

16. Gjate viteve 2005-2007 tregu i prodhimit të miellit ka qenë shumë i përqendruar. Indeksi HHI në vitin 2005 ka qenë 2,765 duke u ulur në 2,442 gjatë vitit 2006 dhe në 2,036 gjatë vitit 2007. Niveli i përqendrimit është ulur nga viti në vit duke arritur në një ndarje proporcionale në 8 mujorin e vitit 2008 midis “Bloja” Sh.a dhe “Atlas” Sh.a, por përsëri shkalla e përqendrimit me 1,842 në këtë vit është përsëri e lartë.

17. Nga analiza e tregut të shitjes së miellit për bukë, rezultoi se ky treg paraqet karakteristikat e një tregu oligopolistik me tre ndërmarrje me pjesë tregu të konsoliduara gjatë viteve 2005-2008. Ndërmarrjet me fuqi tregu janë “Atlas” Sh.a, “Bloja” Sh.a dhe “Shoqëria Anonime Mielli” Sh.a.

### **V. Marrëveshja e ndaluar midis “Bloja” Sh.a dhe “Atlas” Sh.a**

18. Nga inspektimi i kryer nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, me datë 22.01.2009 në ndërmarrjen “Atlas” SH.A, në kompjuterët e kësaj ndërmarrjeje janë gjetur disa skedarë elektronikë<sup>8</sup> të cilët përmbanin të dhëna lidhur me transaksionet midis ndërmarrjes “Bloja” Sh.a dhe ndërmarrjes “Atlas” Sh.a. Këto të dhëna janë printuar nga kompjuteri i financës dhe janë evidentuar në procesverbalin e inspektimit datë 22.01.2009, duke i numërtuar me numrat 1-12<sup>9</sup> (referuar raportit të hetimit).

19. Nga inspektimi në ndërmarrjen “Bloja” Sh.a, në kompjuterin e zyrës së financës së kësaj ndërmarrjeje u gjet një skedar elektronik i emërtuar “Bloja Atlasi” 2008, në të cilin gjendej tabela “Përmbledhëse e zhdoganimeve për vitin 2008”,

<sup>7</sup> (Concentration rate 3) Shuma e pjesëve të tregut që zene tre ndërmarrjet me të madhe në tregun e shitjes së miellit është XXX % për vitin 2005; XXX % për vitin 2006; XXX % për vitin 2007 dhe XXX % për 8-mujorin e vitit 2008.

<sup>8</sup> Këto skedarë elektronikë janë printuar dhe për marrjen e tyre në dorëzim, është mbajtur procesverbali i datës 22.01.2009. Vetë ndërmarrjet, në seancën dëgjimore, nuk paraqitën kundërshtime në lidhje me përmbajtjen dhe formën e këtyre skedarëve të marrë nga Sekretariati.

<sup>9</sup> Numërtimi është kryer nga Grupi i Inspektimit. Të dhënat e skedarëve janë printuar nga grupi i punës dhe ia janë bashkëlidhur procesverbalit të datës 22. 01. 2009. Siç u tha dhe më sipër ky procesverbal është nënshkruar dhe nga ndërmarrjet, dhe mbi përmbajtjen e tij, asnjë ndërmarrje nuk kanë paraqitur kontestime.

në të cilën pasqyrohen të dhëna mbi importet për vitin 2008 si: sasia, çmimi, vlefëta, taksat doganore, TVSH, pagesat doganore. Të dhënat e kësaj tablele korrespondojnë me të dhënat e gjetura në kompjuterin e financës së ndërmarrjes “Atlas” Sh.a.

20. Të gjitha evidencat e gjetura gjatë inspektimit në ndërmarrjet “Bloja” Sh.a dhe Atlas sh.a u vërtetuan edhe nga të dhënat e marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, të cilat paraqiten në tabelën e mëposhtme :

**Tabela për importet e përbashkëta të grurit nga ndërmarrjet “Atlas” Sh.a dhe “Bloja” Sh.a<sup>10</sup>**

KONFIDENCIALE

**Nga verifikimi i evidencave të mësipërme, rezultoi se:**

- Këto dy ndërmarrje, qe kanë fuqi ekonomike të ndjeshme në tregun e prodhimit dhe shitjes së miellit për prodhimin e bukës, shkëmbejnë informacione mbi ofertën, pra njohin fuqinë ofertuese të njëra tjetrës.
- Ndërmarrjet “Atlas” Sh.a dhe “Bloja” Sh.a mbajnë të dhëna të sakta për *sasinë, çmimin, vleftën, taksat doganore, TVSH-në, pagesat doganore*, shpenzimet e zhdoganimit etj., të njëra – tjetrës.
- Ndajnë shpenzimet e doganës, shpenzimet e spedicionit dhe shpenzime të tjera.
- Mbajnë të dhëna të sakta mbi detyrimet dypalëshe (arkëtimet dhe gjendjet debitore) të njëri tjetrit, sasinë e grurit të blerë dhe shpenzimet e zhdoganimit.
- Zotërojnë së bashku XXX% të tregut të importit të grurit, XXX % të tregut të shitjes së grurit, XXX% (XXX% “Atlas” SH.A dhe XXX% “Bloja” SH.A) të tregut të prodhimit të miellit, teknologji dhe kapacitete të larta përpunimi, duke u bërë një faktor i fuqishëm për të kufizuar konkurrencën e lirë dhe efektive në treg.
- Ndërmarrjet “Atlas” Sh.a dhe “Bloja” Sh.a kanë fuqi tregu për të shkaktuar kufizime të konkurrencës, pasi shkalla e përqendrimit të tregut për shkak të pjesëve të konsiderueshme të këtyre ndërmarrjeve është e lartë, fuqia kundërvepruese e të gjithë konkurrentëve të tjerë është me e vogël se e ndërmarrjeve “Bloja” Sh.a dhe “Atlas” Sh.a, fuqia kundërvepruese e klientëve (mullinj të vegjël dhe prodhues buke) është e vogël. Palët kane stabilitet të pjesëve të tregut në vite dhe janë në dy nga tre konkurrentët kryesorë (CR3) në të gjitha tregjet.

21. Është konstatuar se gjatë periudhës së marrëveshjes ndërmarrjet Atlas Sh.a dhe Bloja Sh.a, nuk kanë sjellje konkurruese në tregun e prodhimit dhe shitjes së miellit, pasi:

---

<sup>10</sup> Burimi i të dhënave Drejtoria e Përgjithëshme e Doganave

- Referuar faturave tatimore<sup>11</sup> të shitjes së miellit për ndërmarrjen “Bloja” Sh.a dhe “Atlas” Sh.a për periudhën 1-27 shkurt 2008, rezultoi se të dyja ndërmarrjet kanë aplikuar të njëjtin çmim të shitjes së miellit në vlerën XXX lekë /kg. Konkretisht ndërmarrja Atlas Sh.a ka faturuar me çmimin XXX lekë/kg në XXX fatura nga XXX fatura gjithsej<sup>12</sup> dhe ndërmarrja “Bloja” Sh.a ka faturuar në XXX fatura nga XXX fatura gjithsej të njëjtin çmim të shitjes së miellit .
- Këto dy ndërmarrje ndjekin të njëjtin trend të çmimit të shitjes së miellit për periudhën mars-gusht 2008. Në data 25 dhe 27 shkurt të vitit 2008, këto ndërmarrje kanë rritur çmimin e shitjes së miellit me të njëjtin indeks prej 1.26<sup>13</sup>, vërtetuar nga faturat tatimore të shitjes së miellit të sjella nga vetë ndërmarrjet.
- Nga procesverbalet e vlerësimeve të realizuara nga organet tatimore<sup>14</sup>, rezultoi se këto dy ndërmarrje aplikojnë shpesh të njëjtin çmim të shitjes së miellit gjatë muajit shkurt 2008.

22. Duke vlerësuar çmimin e shitjes së miellit, ndarjen e burimeve të furnizimit, gjatë viteve 2007-2008, si dhe sjelljen jo konkurruese të këtyre ndërmarrjeve në treg, vërtetohet marrëveshja<sup>15</sup> e ndaluar ndërmjet ndërmarrjeve “Bloja” Sh.a dhe “Atlas” Sh.a, e parashikuar në nenin 4 , pika 1 të “Ligjit”. Sipas evidencave të administruara, marrëveshja i ka shtrirë efektet për periudhën tetor 2007 -31 gusht 2008.

23. Marrëveshja e ndaluar është horizontale, pasi ndërmarrjet së bashku veprojnë në të njëjtin nivel tregu (në tregun e importit të grurit për bukë), dhe për shkak të integritimit vertikal të tyre, ka sjellë pasoja në tregun e shitjes së grurit dhe të prodhimit e shitjes së miellit për prodhimin e bukës.

24. Komisioni i Konkurrencës pasi konstatoi marrëveshjen e ndaluar, me Vendimin Nr. 113 datë 19.05.2009 “Për ndalimin e marrëveshjes në tregun e importit të grurit dhe prodhimit të miellit midis ndërmarrjeve “Atlas” Sh.a dhe “Bloja” Sh.a, vendosi ndalimin e kësaj marrëveshjeje në kuptim të ‘Ligjit’ dhe ky vendim u është komunikuar këtyre ndërmarrjeve.

<sup>11</sup> Të sekuestruara nga ndërmarrja “BLOJA” SH.A, sipas procesverbalit të inspektimit të datës 26. 06. 2008 dhe 20. 01. 2009, dhe të sjella nga “ATLAS” SH.A pranë Autoritetit të Konkurrencës me shkresën Nr. 447 datë 28. 10. 2008.

<sup>12</sup> Ndërmarrja Atlas Sh.a tregton tipe të ndryshme mielli. Fiksimi i çmimit XXX lekë/kg është aplikuar në miellin e tipit Assos Pl.50 kg i cili ze rreth 36% të volumit total të miellit të shitur gjatë muajit shkurt 2008. Numri i faturave të leshuara për këtë tip mielli është XXX copë.

<sup>13</sup> Referojuni faturave tatimore të shitjes së datës 25 shkurt 2008 për ndërmarrjen “Bloja” SH.A dhe 27 shkurt për ndërmarrjen “Atlas” SH.A.

<sup>14</sup> Sipas raporteve të vlerësimit tatimor të sjella nga ndërmarrjet “Bloja” SH.A dhe “Atlas” SH.A pas seancës dëgjimore, në të cilat janë paraqitur deklaratat e furëtarve (blerësit e miellit).

<sup>15</sup> Blerjet e përbashkëta, nuk janë të ndaluara, por mjafton që kjo blerje e përbashkët të mos sjellë kufizim të konkurrencës. Në rastin konkret ndërmjet ndërmarrjeve “ATLAS” SH.A dhe “BLOJA” SH.A ka patur blerje të përbashkëta, por kjo blerje e përbashkët ka sjellë si pasojë kufizimin e konkurrencës. ë

25. Komisioni i Konkurrences në vlerësimin në tërësi të sjelljes së ndërmarrjeve në treg, është drejtuar dhe nga interesi publik në tërësi dhe ai i konsumatoreve në veçanti.

Për sa më sipër Komisioni i Konkurrencës konkludoi se ndërmarrjet “Atlas” Sh.a dhe “Bloja” Sh.a, nuk kanë konkurruar në tregun përkatës, pasi nga evidencat dhe analiza e sjelljes në tregjet përkatëse, rezultoi se këto ndërmarrjet koordinojnë sjelljen në treg përsa i përket përcaktimit të çmimeve të tregtimit të produkteve përkatëse, si dhe ndajnë burimet e furnizimit (importi i grurit).

Kjo praktikë e bashkërenduar në zbatim të neneve 3, pika 4 dhe pikës 1, germa “a” dhe “c” të nenit 4 të Ligjit Nr 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” është marrëveshje e ndaluar pasi pengon dhe kufizon konkurrencën në tregun përkatës.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja d, nenin 4 pika 1 gërma “a”, dhe “c”, nenin 74, pika 1, gërma “a” dhe nenin 80 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

### **V E N D O S I:**

1. Të gjobisë ndërmarrjen “Bloja” Sh.a , për pjesëmarrje në marrëveshjen e ndaluar, në shumën prej 38 548 251( tridhjetë e tetë milion e pesëqind e dyzetetë mijë e dyqind e pesëdhjetë e një) Lekë;
2. Të gjobisë Ndërmarrjen “Atlas” Sh.a për pjesëmarrje në marrëveshjen e ndaluar në shumën prej 27 848 563 (njëzeteshtatë milion e tetëqind e dyzetetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tre) Lekë;
3. Ngarkohet Drejtoria e Hetimit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për zbatimin e këtij vendimi;
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm t’i komunikojë këtë vendim ndërmarrjeve të mësipërme;
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**Servete GRUDA**

( \_\_\_\_\_ )  
**Anëtar**

**Rezana KONOMI**

( \_\_\_\_\_ )  
**Anëtar**

**Koço BROKA**

( \_\_\_\_\_ )  
**Anëtar**

**Lindita MILO (LATI)**

